

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Durrës

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“QEPJE FAQE KEPUCESH”

Kodi: QFK-20

Miratoi:

DREJTOR

.....

Durrës, 2020

PROGRAMI I KURSIT TE VECANTE

“QEPJE FAQE KËPUCESH”

(QFK – 20)

I. Profili Profesional i qepësit të faqeve të këpucëve.

a) Karakteristikat e qepësit të faqeve të këpucëve

Qepësi i Faqeve të Këpucëve është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo vetpunësuar në Fasoneri apo biznes familjar, që ofrojnë shërbime të prodhimit të këpucëve. Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, qepësi duhet të zotërojë **njohuri dhe shprehje** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë të qepjes së faqeve të këpucëve. Suksesi i Qepësit të Faqeve të Këpucëve është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** dhe qëndrime personale si: gadishmëria dhe përgjegjshmëria për të punuar, kujdesi dhe garantimi i sigurisë së cilësisë së shërbimit/produktit, përqendrimi në punë, komunikimi me etikë profesionale me koleget dhe eprorët, shkathtësia në punë, korrektësia, disiplina, guximi dhe këmbëngulja, respektimi i mjedisit dhe kushteve të punës, etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe të përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e qepësit të faqeve të këpucëve.

Profesioni i Qepësit të Faqeve të Këpucëve është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për projekte, ide për prodhimin e këpucëve dhe për zbatimin e tyre, lidhur kjo edhe me kërkesat si dhe sugjerimet e klientëve. Ai mund të punësohet në fasoneri dhe në rrobaqepsi ku qepen veshje prej lekure, si dhe mund të vetëpunësohet në një biznes privat për të ofruar këto shërbime. Një individ mund të ushtrojë profesionin e qepësit të faqeve të këpucëve fillimisht si punëtor i thjeshtë. Me përvojë punë dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e kontrollorit të cilësisë. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një qepës mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse, fillimisht si ndihmesë përgjegjës manovrie, përgjegjës manovrie dhe me pas si teknik këpucësh. Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e Qepjes së Faqeve të Këpucëve, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Qepje Faqe Këpucësh”.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Qepje Faqe Këpucësh”.

Në përfundim të Kursit “Qepje Faqe Këpucësh”, kursantët do të jenë të aftë të:

- zbatojnë standardet e profesionit;
- organizojnë punën dhe vendin e punës në një repart punë të prodhimit të këpucëve;
- përdorin katalogë të ndryshëm, në format fizik dhe elektronik;
- realizojnë qepjen e faqeve të këpucëve me dorë;
- realizojnë qepjen e faqeve të këpucëve me makinë;
- përzgjedhin aksesoret zbukurues, sipas modelit të kërkuar, për burra dhe gra;
- vendosin aksesoret zbukurues në faqet e këpucëve, me dorë, me makineri, me ngjitje;
- përdorin veglat, materialet, makineritë dhe instrumentet e punës;
- mirëmbajnë veglat, materialet, makineritë dhe instrumentet e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale me kolegët, eprorët, klientët;

- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- zbatojnë kuadrin ligjor të veprimtarisë së qepësit të faqeve të këpucëve;
- zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës;
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Qepje Faqe Këpucësh”.

Rekomandohet që pjesmarrësit në Kursin “Qepje Faqe Këpucësh”, duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Qepje Faqe Këpucësh”.

300 orë mësimore

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e kursit “Qepje Faqe Këpucësh”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e Qepësit të faqeve të këpucëve.	QFK-01-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Qepësit të faqeve të këpucëve. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, makinëritë dhe materialet e punës së qepësit të faqeve të këpucëve. 3. Kursanti përshkruan rregullat e higjienës, etikës, të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në një repart pune të qepjes së faqeve të këpucëve. 4. Kursanti përshkruan proceset kryesore të punës për qepjen e faqeve të këpucëve me dorë dhe me makinë.
2	Qepja e faqeve të këpucëve me dorë.	QFK-02-20	70 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti organizon punën dhe vendin e punës për fillimin e qepjes me dorë të faqeve të këpucëve. 2. Kursanti realizon qepjen e faqeve të këpucëve me dorë.
3	Qepja e faqeve të këpucëve me makinë.	QFK-03-20	130 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti organizon punën dhe vendin e punës për fillimin e qepjes së faqeve të këpucëve me makinë. 2. Kursanti realizon qepjen e faqeve të këpucëve me makinë.

4	Vendosja e aksesoreve zbukurues në faqet e këpucëve, sipas modelit të kërkuar, për gra dhe burra.	QFK-04-20	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti për zgjedh aksesorët zbukurues që do të vendose në faqet e këpucëve, për gra dhe burra, sipas modelit të kërkuar. 2. Kursanti vendos aksesorët zbukurues në faqet e këpucëve, sipas modelit të kërkuar, për gra dhe burra.
---	---	-----------	--	---

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e kursit për të gjitha rezultatet mësimore që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Qepje faqe këpucësh:

1.Moduli “Hyrje në profesionin e qepësit të faqeve të këpucëve”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E QEPËSIT TË FAQEVE TË KËPUCËVE.	QFK-01-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të Qepësit të faqeve të këpucëve, me mjedisin, veglat, makineritë dhe materialet e punës, me rregullat e higjienës, etikës, të sigurojë në punë e të mbrojtjes së mjedisit si dhe me proceset kryesore të punës për qepjen e faqeve të këpucëve, me dorë dhe me makinë.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori, 10% praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë mbaruar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të qepësit të faqeve të këpucëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë natyrën e punës së qepësit të faqeve të këpucëve; - të përshkruajë procesin zinxhir të punës dhe rëndësinë e tij në një fabrikë të prodhimit të këpucëve; - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e qepjes së faqeve të këpucëve për individin; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së qepësit të faqeve të këpucëve;	

- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së qepësit të faqeve të këpucëve;
- të përshkruajë makineritë, mjetet, pajisjet, materialet e punës që përdor qepësi;
- të tregojë organizimin e punës dhe të vendit të punës në një repart pune;
- të përshkruajë proceset kryesore të veprimtarisë së qepësit;
- të përshkruajë bazën e të dhënave për procesin e qepjes së faqeve të këpucëve;
- të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të qepësit;
- të përshkruajë kërkesat profesionale të qepësit;
- të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së qepësit të faqeve të këpucëve;
- të përshkruajë kërkesat për licensim për ushtrim profesional të qepësit të faqeve të këpucëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, makineritë dhe materialet e punës së qepësit të faqe këpucëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjedisin e punës në një repart pune të qepjes së faqeve të këpucëve;
- të organizojë mjedisin dhe vendin e punës së qepësit të faqeve të këpucëve;
- të mirembajë mjedisin dhe vendin e punës;
- të dallojë makineritë që përdoren në procesin e qepjes me makinë të faqeve të këpucëve;
- të përshkruajë makinën qepëse, pjesët përbërëse dhe funksionimin e tyre;
- të përshkruajë makinerinë "Gasparon" dhe funksionin e saj;
- të përshkruajë makinën e "Shkajimit" dhe funksionimin e saj;
- të përshkruajë makinën "Bordatrice" (makina për bërjen e bordurave) dhe funksionimin e saj;
- të përshkruajë makinën "Ochelatrice" (makina e vendosjes së percinave) dhe funksionimin e saj;
- të përshkruajë makinën "Plan" (makina për qepjen e etiketave) dhe funksionimin e saj;
- të përshkruajë makinën e vendosjes së numrave të këpucëve dhe funksionimin e saj;
- të dallojë veglat, mjetet e punës së qepësit të faqeve të këpucëve;
- të tregojë përdorimet e veglave, mjetëve të punës;
- të mirëmbajë makineritë, veglat, mjetet e punës së qepësit;
- të dallojë materialet e punës së qepësit dhe përdorimet e tyre;
- të dallojë llojet e lëkurave;
- të tregojë pjesët ndihmëse të lëkurës si: sfungjeri, astari dhe për çfare shërbejnë ato;

- të tregojë llojet e penjëve dhe gjilpërave që përdoren për qepjen me dorë, sipas modelit, trashësisë dhe ngjyrës së lëkurës;
- të tregojë llojet e penjëve dhe gjilpërave që përdoren për qepjen me makinë, sipas modelit, trashësisë dhe ngjyrës së lëkurës;
- të tregojë llojet e ngjitësve që përdoren për të ngjitur astarin me lëkurën;
- të sistemojë materialet e punës së qepësit të faqeve të këpucëve;
- të mirembajë materialet e punës së qepësit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e higjienës, etikës, të sigurtë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në një repart pune të qepjes së faqeve të këpucëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rregullat e higjienës personale e mjedisore gjatë procesit të qepjes;
- të tregojë rëndësinë e higjienës për disa lloje lëkurësh që mund të marrin njolla edhe nga prekja me dorë ;
- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët dhe kolegët
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë procesit të qepjes së faqeve të këpucëve
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga zjarri rryma elektrike dhe rreziqe të tjera
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga përdorimi i materialeve si: mastici, bojra për lyerjen e lëkurave, diluenti; (materiale këto me përbërës toksik);
- të përshkruajë rregullat e përdorimit, të mirembajtjes dhe ruajtjes së materialeve e mjeteve të punës së qepësit;
- të tregojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë;
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit të punës në një repart pune të qepjes së faqeve të këpucëve;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët dhe kolegët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan proceset kryesore të punës për qepjen e faqeve të këpucëve me dorë dhe me makinë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e punës zinxhir (seri) në një repart pune të qepjes së faqeve të këpucëve;
- të shpjegojë rëndësinë e kryerjes si duhet dhe në kohe të procesit paraardhës të punës, në funksion të atij pasardhës;
- të përshkruajë konvejerin dhe për çfarë shërben ai;
- të tregojë si vendoset puna në konvejer;
- të përshkruajë procesin e punës dhe modelet për qepjen me dorë të lëkurës;
- të përshkruajë procesin e punës dhe modelet për qepjen me makinë të lëkurës;
- të përshkruajë procesin e qepjes me dorë të tegelave me një gjilpërësh dhe dy gjilpërësh, sipas modelit;
- të përshkruajë procesin e qepjes me makinë të tegelave me një gjilpërësh dhe dy gjilpërësh, sipas modelit të kërkuar;
- të përshkruajë procesin e shkajimit të lëkurës sipas modelit;
- të shpjegojë procesin e ngjitjes së lëkurës së prerë sipas modelit të kërkuar me astarin;
- të shpjegojë procesin e vijëzimit të lëkurës për të qepur tegelat zbukurues sipas modelit;
- të përshkruajë procesin e vendosjes së aksesorëve zbukurues, sipas modelit të kërkuar si: lule, togeza, percina, zinxhirë, aplikacione të ndryshme, kopsa etj;
- të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të cilësisë së punës së kryer.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në klasë/ laborator. Rekomandohen dhe vizita në fabrika këpucësh.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në një fabrikë këpucësh. Atyre duhet t'u jepen detyra të ndryshme që të vëzhgojnë dhe të analizojnë mjedisin, mjetet, materialet, makinerite, instrumentet e punës dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e qepës të faqeve të këpucëve. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore, klase/laborator e pajisur me mjete dhe materiale pamore; – Mjedise reale të punës në një fabrikë këpucësh, ku kursantët të njihen nga afer me makineritë e ndryshme që përdoren për qepjen e faqeve të këpucëve si dhe me funksionimin e tyre; – Komplet i materialeve, mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës për qepjen e faqeve të këpucëve; – Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	---

2. Moduli “Qepja e Faqeve të Këpucëve me dorë”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	QEPJA E FAQEVE TË KËPUCËVE ME DORË.	QFK-02-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me organizimin e punës, vendit të punës për fillimin e qepjes me dorë të faqeve të këpucëve, si dhe me realizimin e qepjes së tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e Qepësit të Faqeve të Këpucëve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti organizon punën dhe vendin e punës për fillimin e qepjes me dorë të faqeve të këpucëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të përgatisë vendin e punës; – të përzgjedhë materialet dhe mjetet e nevojshme për fillimin e qepjes me dorë; – të përzgjedhë lëkurën; – të ekzaminojë lekuren; – të identifikojë defektet e mundshme të lekures; – të bëjë shkajimin e lëkurës së prerë paraprakisht sipas modelit; – të përzgjedhë materialet ndihmëse të lëkurës si: sfungjeri, astari; – të përzgjedhë ngjithësin e duhur për të ngjitur astarin me lëkurën; – të ngjisë modelin e prerë sipas modelit të kërkuar me astarin; – të vijëzohet tegelat zbukurues në lëkurën e përgatitur për qepje ;	

- të lyejë format e prera të lëkurës sipas ngjyrës së modelit të kërkuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti realizon qepjen e faqes së këpucëve me dorë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përshkruajë procesin e qepjes me dorë të faqeve të këpucëve;
- të tregojë procesin e qepjes me dorë të tegelit të drejtë me një dhe dy gjilpëra;
- të tregojë procesin e qepjes me dorë të tegelit zig - zag me një dhe dy gjilpëra;
- të tregojë procesin e qepjes me dorë të kordonit;
- të për zgjedhë faqet e këpucëve që do të qepen me dorë;
- të ndajë faqet e këpucëve (e majtë, e djathtë), sipas shenjës dalluese të vendosur paraprakisht ;
- të për zgjedhë gjilpërën e duhur për qepjen me dorë të tegelit të drejtë dhe zig - zag me një gjilpërë , sipas trashësisë së lëkurës;
- të për zgjedhë perin në trashësi dhe ngjyrë, përshtatur me trashësinë dhe ngjyrën e lëkurës;
- të vendosë gishtëzën ;
- të realizojë qepjen e tegelave të drejtë dhe zig - zag me dorë me një gjilpërë;
- të për zgjedhë gjilpërën e duhur për qepjen me dorë të tegelave të drejtë dhe zig - zag me dy gjilpëra , sipas trashësisë së lëkurës ;
- të për zgjedhë perin në trashësi dhe ngjyrë , përshtatur me trashësinë dhe ngjyrën e lëkurës , për qepjen me dorë me dy gjilpëra të tegelit të drejtë dhe zig - zag;
- të realizojë qepjen e tegelave të drejtë dhe zig - zag me dorë me dy gjilpëra;
- të për zgjedhë gjilpërën e duhur për qepjen me dorë të kordonit;
- të për zgjedhë perin e duhur për qepjen me dorë të kordonit;
- të realizojë qepjen e kordonit me dorë ;
- të kontrollojë punën e kryer lidhur me llojet e qepjeve të mësipërme, me dorë;
- të riparojë defektet e mundshme, nëse është e nevojshme;
- të pastrojë dhe mirëmbajë vendin e punës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë/laborator. Rekomandohen vizita dhe praktika në reparte të prodhimit të këpucëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në klase/laborator. Atyre duhet t'u jepen detyra praktike për realizimin e qepjes së faqeve të këpucëve me dorë.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
domosdoshme për
realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë/laborator e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në një fabrikë këpucësh.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për realizimin në praktike të çështjeve që trajtohen në këtë modul.
- Makina e Shkajimit.
- Materiale të ndryshme si: lëkurë, astar, ngjitësa.
- Aksesore të ndryshme si: penj, gjilpëra, gishtëz.
- Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Qepja e faqeve të këpucëve me makinë”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	QEPJA E FAQEVE TË KËPUCËVE ME MAKINË.	QFK-03-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me organizimin e punës, vendit të punës, për fillimin e qepjes së faqeve të këpucëve me makinë, si dhe me realizimin e qepjes së tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	130 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulet “Hyrje në profesionin e qepësit të faqeve të këpucëve” dhe “Qepja e faqeve të këpucëve me dorë”.	

**Rezultatet e të
mësuarit (RM)
dhe procedurat
e vlerësimit**

RM 1 Kursanti organizon punën dhe vendin e punës për fillimin e qepjes së faqes së këpucëve me makinë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë makinën qepëse për fillimin e qepjes së faqeve të këpucëve me makine;
- të kontrollojë makinën qepëse për eficensën e saj;
- të vajisë makinën qepëse;
- të përzgjedhë materialet dhe mjetet e nevojshme për fillimin e qepjes me makinë;
- të përzgjedhë lëkurën;
- të identifikojë defektet e mundshme të lëkurës;
- të bëjë shkajimin e lëkurës së prerë paraprakisht sipas modelit;
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të lëkurës si sfungjeri dhe astari;
- të përzgjedhë ngjitësin e duhur për të ngjitur astarin me lëkurën;
- të ngjisë lëkurën e prerë sipas modelit të kërkuar me astarin;
- të vijëzohet tegelat zbukurues në lëkurën e përgatitur për qepje;
- të lyejë format e prera të lëkurës sipas ngjyres dhe modelit të kërkuar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti realizon qepjen e faqeve të këpucëve me makinë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përshkruajë procesin e qepjes me makinë të faqeve të këpucëve;
- të përshkruajë procesin e qepjes me makinë të tegelit të drejtë me një dhe dy gjilpëra;
- të përshkruajë procesin e qepjes me makinë të tegelit zig - zag;
- të tregojë procesin e qepjes me makinë (bordatrice) të kordonit;
- të përzgjedhë faqet e këpucëve që do të qepen me makinë;
- të ndajë faqet e këpucëve (e majtë, e djathtë), sipas shenjës dalluese të vendosur paraprakisht;
- të përzgjedhë gjilpërën e duhur për qepjen me makinë të tegelit të drejtë dhe zig- zag, me një gjilpërë, sipas trashësisë së lëkurës;
- të përzgjedhë perin në trashesi dhe ngjyrë, përshtatur me trashësinë dhe ngjyrën e lëkurës, për qepjen me makinë të tegelit të drejtë dhe zig- zag me një gjilpërë;

- të realizojë me makinë tegela të drejte dhe zig- zag me një gjilpërë;
- të përzgjedhë gjilpërën e duhur për qepjen me makinë të tegelit të drejtë me dy gjilpëra, sipas trashësisë së lëkurës që do të qepet;
- të përzgjedhë perin, në trashësi dhe ngjyrë, për qepjen me makinë të tegelit të drejtë me dy gjilpëra, përshtatur me trashësinë dhe ngjyrën e lëkurës;
- të realizojë qepjen me makinë të tegelit të drejtë me dy gjilpëra të faqeve të këpucëve;
- të përzgjedhë gjilpërën e duhur, përshtatur me trashësinë e lëkurës për qepjen e kordonit në Bordatrice;
- të përzgjedhë perin, në trashësi dhe ngjyrë, përshtatur me trashësinë dhe ngjyrën e lëkurës për qepjen e kordonit;
- të realizojë qepjen e kordonit në Bordatrice;
- të kontrollojë punën e kryer lidhur me llojet e mësipërme të qepjeve me makinë;
- të riparojë defektet e mundshme, nëse është e nevojshme;
- të pastrojë vendin e punës;
- të pastrojë makinën qepëse;
- të sistemojë mjetet e përdorura gjatë proceseve të qepjes me makinë;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës , të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë/laborator. Rekomandohen vizita dhe praktika në reparte të prodhimit të këpucëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në klase/laborator. Atyre duhet t'u jepen detyra praktike për realizimin e qepjes së faqeve të këpucëve me makinë. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë/laborator e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës në një fabrikë këpucësh. – Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për realizimin në praktike të çështjeve që trajtohen në këtë modul. – Makina qepese. – Makina e Shkajimit. – Materiale të ndryshem si: lekure, astar, ngjitësa. – Aksesore të ndryshem si: penj , gjilpëra etj. – Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	---

4. Moduli “Vendosja e aksesorëve zbukurues në faqet e këpucëve, sipas modelit të kërkuar, për gra dhe burra ”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	VENDOSJA E AKSESORËVE ZBUKURUES NË FAQET E KËPUCËVE, SIPAS MODELIT TË KËRKUAR, PËR GRA DHE BURRA.	QFK-04-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me përzgjedhjen e aksesorëve zbukurues për faqet e këpucëve, sipas modelit të kërkuar, për gra dhe burra, si dhe me vendosjen e tyre me dorë, me makineri, me ngjitje.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar modulet “Hyrye në profesionin e qepësit të faqeve të këpucëve”, “Qepja e faqeve të këpucëve me dorë” dhe “Qepja e faqeve të këpucëve me makinë”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përzgjedh aksesorët zbukurues që do të vendosë në faqet e këpucëve, për gra dhe burra, sipas modelit të kërkuar. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të kuptojë modelin e kërkuar për vendosjen e aksesorëve zbukurues në faqet e këpucëve për gra dhe burra; – të përzgjedhë aksesorët zbukurues, sipas modelit, për faqet e këpucëve për gra si: lule, aplikacione të ndryshme, togëza, percina, zinxhirë, kopsa etj.; – të përzgjedhë aksesorët zbukurues, sipas modelit për faqet e këpucëve për burra si: togëza, zinxhirë, percina. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.	

RM 2 Kursanti vendos aksesorët zbukurues në faqet e këpucëve, sipas modelit të kërkuar, për gra dhe burra.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përshkruajë procesin e vendosjes së aksesorëve zbukurues;
- të përgatisë vendin e punës për vendosjen e aksesorëve zbukurues;
- të për zgjedhë veglat, materialet, mjetet e nevojshme për vendosjen e aksesorëve zbukurues;
- të vendosë aksesorët zbukurues për gra, me qepje me dorë si: lule, kopsa etj.;
- të vendosë aksesorë zbukurimi për gra, me qepje me makinë si: togëza, zinxhirë;
- të vendosë percinat tek faqet e këpucëve për gra me Ochelatrice (makineria e vendosjes së percinave);
- të qëndisë me makineri aplikacione të ndryshme zbukuruese në faqet e këpucëve për gra;
- të vendosë aksesorë zbukurues për gra me ngjitje si: lule, kopsa etj.;
- të vendosë aksesorët zbukurues tek faqet e këpucëve për burra, me makineri si : togëza, zinxhirë, percina etj.;
- të kontrollojë punën e kryer;
- të dallojë defektet e mundshme;
- të riparojë defektet nëse është e mundshme;
- të pastrojë vendin e punës;
- të sistemojë veglat, mjetet dhe materialet e përdorura për vendosjen e aksesorëve zbukurues për gra dhe burra;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë/laborator. Rekomandohen vizita dhe praktika në reparte të prodhimit të këpucëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në klase/laborator dhe në mjediset e punës në një repart pune të një fabrike këpucësh. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për vendosjen e aksesorëve zbukurues në faqet e këpucëve, për gra dhe burra, sipas

	modelit të kërkuar. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë/laborator e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës në një fabrikë këpucësh. – Komploti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për realizimin në praktike të çështjeve që trajtohen në këtë modul. – Aksesorë të ndryshëm zbukurues për burra dhe gra si: lule, togeza, zinxhire, percina, kopsa etj. – Materiale të ndryshëm ngjitës. – Makineria “Ochelatrice” për vendosjen e percinave. – Penj me trashesi dhe ngjyra të ndryshme, për qepjen e aksesorëve zbukurues. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
